



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA DURRËS  
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr.83, datë 28.06.2021

**PËR  
MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË VENDIMIT TË KËSHILLIT BASHKIAK NR. 202,  
DATË 24.02.2010 “PËR MIRATIMIN E ZONAVE TË DESTINUARA PËR PARKIM  
NË QYTETIN E DURRËSIT, NË TË CILAT QËNDRIMI I MJETEVE  
KUSHTËZOHET NGA PAGESA E NJË SHUME QË VARET NGA KOHËZGJATJA E  
QËNDRIMIT”**

Në zbatim të Ligjit Nr. 139, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, Ligjit Nr.8378, datë 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, Ligjit Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr. 202, datë 24.02.2010 “Për miratimin e zonave të destinuara për parkim në qytetin e Durrësit, në të cilat qëndrimi i mjeteve kushtëzohet nga pagesa e një shume, që varet nga kohëzgjatja e qëndrimit”, Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr.208, datë 09.04.2010 “Për miratimin e zonave të destinuara për parkim në qytetin e Durrësit, kapacitetin e vendeve të parkimit për zonë, tarifatat dhe kohëzgjatja e qëndrimit” si dhe sipas relacionit të përgatitur nga Drejtoria e Shërbimeve, me propozim të Zëvendëskryetares së Bashkisë, e cila kryen funksionet e Kryetarit të Bashkisë,

**KËSHILLI BASHKIAK  
VENDOSI:**


1. Miratimin e ndryshimit të Vendimit të Këshillit Bashkiak nr.202, datë 24.02.2010 “Për miratimin e zonave të destinuara për parkim në qytetin e Durrësit, në të cilat qëndrimi i

mjeteve kushtëzohet nga pagesa e një shume që varet nga kohëzgjatja e qëndrimit”, sipas dokumentacionit bashkëngjitur, si më poshtë vijon:

- Sheshi pranë Sfinks.
  - Sheshi pranë Bar Portofino.
  - Sheshi Vollga pranë Autoritetit Portual Durrës.
  - Sheshi në Rrugën “Mars 91” Durrës.
  - Sheshi pranë Hekurudhës Shqiptare me hyrje në Rrugën “Mars 91”.
  - Sheshi tek Muzoleumi.
  - Sheshi në territorin e brendshëm të Pallatit të Sportit “Ramazan Njala”.
  - Sheshi pranë tregut fshatar.
  - Sheshi pranë tregut industrial.
2. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Shërbimeve.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar).

**KRYETARI KËSHILLIT BASHKIAK**

**Ani Dyrmishi**



**U shpall sot me datë 29.06.2021**

Vendodhja e parkimeve publike te propozuar



BASHKIA DURRES  
Dt: 06/7/21 Nr. 7438/22  
PROT



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
PREFEKTI I QARKUT DURRËS

Nr. ~~461~~ / 12 p.fot.



Durrës, më 06.07.2021

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit

KËSHILLIT BASHKIAK ✓

DURRËS

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr. 83 datë 28.06.2021 Për miratimin e ndryshimit të Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 202, datë 24.02.2010 “Për miratimin e zonave të destinuara për parkim në qytetin e Durrësit, në të cilat qëndrimi i mjeteve kushtëzohet nga pagesa e një shume që varet nga kohëzgjatja e qëndrimit”.

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që më jep Ligji Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI  
ROLAND NASTO

